



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

PËRPUNIM DRURI

Niveli IV në KSHK¹, referuar niveli IV të KEK²

C-IV-19

Tiranë, Korrik 2019

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	PËRPUNIM DRURI			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	IV KSHK, referuar niveli IV të KEK	C-IV-19
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Përpunim druri” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, është të përgatitë individët me aftësi praktike, për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejtë me përpunimin e drurit, si specialistë të nivelit teknik/menaxher, për menaxhimin e një brigade, reparti, linjë prodhimi, apo krijimin e menaxhimin e një biznesi privat.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> kanë përfunduar një nga kualifikimet profesionale të drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli III (KSHK), referuar niveli III të KEK, ; janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. kanë aftësi ndryshe, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin. <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucionet përgjegjëse përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimi për këto shkolla.</p>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të këtij niveli si teknik/menaxher i mesëm në këtë drejtim profesional, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në institucione të ndryshme shtetërore dhe shoqëri private, me aktivitete në sektorin e përpunimit të drurit, teknik i mesëm prodhimi e një njësie prodhuese të objekteve prej druri, produkteve gjysmë të gatshme, restaurues, arredues dhe ndërtues etj..</p> <p>Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet si teknik i mesëm në kuadrin e një biznesi individual mikro, të vogël apo të mesëm, të shitjes apo ekspozimit të materialeve dhe prodhimeve në fushën e përpunim drurit. Përfundimi me sukses i këtij kualifikimi profesional i jep të drejtën individit për të fituar diplomën e “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	C-III-16			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Sipermarrje dhe menaxhim biznesi

- Të shpjegojë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit në kontekstin e globalizimit;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të shpjegojë konceptet financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare..);
- Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti;
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të ilustrojë metoda të zgjidhjes së problemeve të menaxhimit në kontekste të ndryshme;
- Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtejshme;
- Të përshkruajë konceptin e ndërmarrjeve me përgjegjësi sociale në kontekste lokale, vendore, rajonale dhe globale;
- Të shpjegojë rëndësinë e vetëvlerësimit të aftësive personale dhe nevojën për kualifikime të vazhdueshme;
- Të shpjegojë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
- Të shpjegojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit), duke u përqendruar në mënyrën e drejtimit, integritimit, motivimit dhe mbikëqyrjes së tyre;
- Të listojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrje në biznes;
- Të shpjegojë dobinë e marketingut në biznes;
- Të listojë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në fushën e biznesit përkatës, si pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes së tij;

Kostot dhe Çmimet

- Të përshkruajë elementët e përcaktimit të kostos së prodhimit/shërbimi të një produkti të caktuar, kostot direkte dhe indirekte, (që përfshijnë koston e materialeve kryesore, të materialeve ndihmëse etj., të shpenzimeve direkte dhe indirekte, deri në magazinimin e produktit të gatshëm etj.);
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së kostos së transportit të jashtëm të prodhimeve, sipas llojit e sasisë së materialit (kur bëhet me mjete të operatoreve të tjerë, ashtu edhe me mjete të vetë ndërmarrjes);
- Të përshkruajë konceptin e normimit e punës në përgjithësi, kohët kryesore dhe ndihmëse të punës në makineri ose pajisje;

- Të përshkruajë elementët e përcaktimit të çmimit të produktit/ arredimit, restaurimit etj. (koston e përcaktuar, fitimin e menduar, afatin e realizimit, sasinë e kërkuar, kërkesën e tregut, çmimin/ofertën e tregut për atë produkt ose produkte të ngjashme, cilësitë ose karakteristikat e veçanta të produktit, garancinë, kushtet për mirëmbajtjen etj.);
- Të interpretojë çmimet e materialeve kryesore dhe atyre ndihmëse që përdoren në njësinë e prodhimeve prej druri dhe gjysmë të gatshme prej druri/ montime, arredime, restaurime etj., sipas veçorisë së tyre për mënyrën e furnizimit, afatin dhe ciklin e përdorimit, volumin dhe mënyrën e magazinimit të tyre etj.;

Organizimi i punës

- Të përshkruajë mënyrën e organizimit të punës për drejtimin/menaxhimin e grupeve të veçanta në varësi të procesit të punës që ato kryejnë (ose të grupeve në tërësi);
- Të përshkruajë nevojat për burime njerëzore dhe kualifikimet përkatëse për realizimin e proceseve të ndryshme
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të urdhrave të punës, të kartave teknologjike të thjeshta të prodhimit/shërbimit, të kontrollit teknik operacional dhe atij përfundimtar etj.;
- Të përshkruajë organizimin e procesit të prodhimit/shërbimit, sipas posteve të punës, deri në magazinimin e prodhimit të gatshëm;
- Të listojë materialet dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e proceseve të punës në përpunimin e drurit.
- Të përshkruajë përcaktimin e rezervës së nevojshme materiale (lëndë të para, ndihmëse, apo prodhime gjysmë të gatshme etj.), për ecurinë e proceseve të punës;
- Të përshkruajë emërtimet e punimeve dhe radhën e kryerjes së tyre për realizimin e një objekti prej druri ose pllakë me bazë druri;
- Të përshkruajë hapat e kontrollit teknik operacional dhe atij përfundimtar, sipas proceseve përkatëse të punës;
- Të përshkruajë mjetet, pajisjet, makineritë e ndryshme dhe të transportit të brendshëm të materialeve e të objekteve prej druri apo prodhimeve gjysmë të gatshme në proces;
- Të listojë dokumentet e magazinimit, të furnizimit apo shpërndarjes së materialeve e të prodhimeve/shërbimeve në proces etj.;
- Të përshkruajë dokumentacionin e nevojshëm teknik të furnizimit apo shpërndarjes së prodhimeve/shërbimeve dhe procedurës së transportit në përgjithësi;

Legjislacioni i punës dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë legjislacionin në vendosjen e repart/fabrikës të përpunimit të drurit ndaj zonës së banuar;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të punës, për marrëdhëniet sipërmarrëse - investitor – klient në fushën e përpunimit të drurit, me theks të veçantë në të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëmarrësit;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë, në fushën e përpunimit të drurit si aspektet teknike, shkallët e përgjegjësisë, dokumentacionin e detyrueshëm, afatet e instruktimit të punonjësve, siguracionet e detyruara të punonjësve në punë, kundrejt aksidenteve dhe jetës etj.;
- Të përshkruajë masat që duhen marrë dhe pajisjet e nevojshme për të evituar ndikimin e

- kimikateve si lëndëve ngjyruese, ngjitëse, lustruese, pluhurit të drurit, ashklave etj.;
- Të përshkruajë veprimet e nevojshme që duhen kryer për të dhënë ndihmën e shpejtë për të dëmtuarin në punë;

Infrastruktura e ndërmarrjes dhe rrjetet inxhinierike për përpunim drurin

- Të interpretojë plan-vendosjet e reparteve dhe njërive të prodhimeve/shërbimeve, skemat e furnizimit të energjisë, të ujit, të telekomunikacionit;
- Të përshkruajë skemat e sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri, shkarkimeve të ujërave, të gazrave, sistemet e aspirimit për mbetjet nga përpunimi i drurit etj.;
- Të interpretojë karakteristikat tekniko-ekonomike të makinerive, të impianteve e të pajisjeve kryesore në linjën apo njësinë e prodhimit, duke pasur parasysh parimin e veprimit, prodhimitarinë ose kapacitetin, fuqinë, shpejtësinë, përmasat, sistemin e komandimit e të sigurisë në punë të tyre, etj.;

Standardet dhe dokumentacioni teknik

- Të lexojë vizatimin teknik të detaleve, të nyjeve, duke përfshirë simbolet, tolerancat, vendosjet, pastërtinë sipërfaqësore, kushtet teknike etj.;
- Të analizojë vizatimet e objekteve prej druri.
- Të shpjegojë mënyrën e zberthimit, detajimit të objektit sipas radhës, vendosjen e përmasave dhe mbipërmasave, si dhe hartimin e kartës shoqëruese /teknologjike;
- Të interpretojë standardet e prodhimeve dhe prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri dhe rregulloret teknike kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe standardet për format dhe përmasat e tregimit të tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit dhe interpretimit të udhëzuesve dhe fletëve shoqëruese të paketimit;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit dhe dokumentimit të propozimeve nga palët e treta dhe argumentimin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e trajtimit dhe të ruajtjes së informacionit;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit TIK;
- Të përshkruajë përdorimet dhe rëndësinë e Programin kompjuterik “AutoCAD”, për projektimin (vizatimin) e detaleve dhe objekteve të thjeshta prej druri;

Menaxhimi i materialeve sipas proceseve teknologjike

- Të përshkruajë llojet e drurit që përdoren në industrinë e përpunimit të tij;
- Të interpretojë, në mënyrë të përgjithshme, vetitë fizike, mekanike e kimike të llojeve të drurit, karakteristikat e lëndëve ndihmëse, si dhe fushën e përdorimit të tyre;
- Të përshkruajë përdorimet e lëndëve ndihmëse si lëndë ngjyruese, ngjitëse, lustruese, aksesore të tjerë metalikë, plastikë etj., në industrinë e përpunimit të drurit;
- Të shpjegojë proceset teknologjike të prodhimit, në repart, fabrikë dhe anekse të tjera, sipas llojit të objektit prej druri (mobilie, parket, vozë etj.) apo gjysmë të gatshme (pllakë qelizore, zdrukth, panel, MDF, melamin etj.) dhe kapacitetit prodhues;
- Të shpjegojë proceset teknologjike të objekteve prej druri në fushën e ndërtimit;

Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë

- Të shpjegojë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, duke përfshirë, përveç aspekteve teknike të sigurisë, plotësimin e dokumentacionit të detyrueshëm për instruktimin e punonjësve;
- Të listojë mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes individuale dhe kolektive duke shpjeguar dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë llojet e mundshme të aksidenteve në fushën e përpunimit të drurit dhe mënyrën e shmangies së tyre;
- Të shpjegojë, për çdo post pune, rregullat e sigurimit teknik në punë;
- Të përshkruajë rëndësinë e afishimit të rregullave të sigurimit teknik në çdo post pune;
- Të shpjegojë legjislacionin shqiptar parandalimit, mbrojtjes, neutralizimit dhe shpëtimit ndaj zjarri, si dhe evakuimin e punonjësve;
- Të shpjegojë saktë veprimet e nevojshme për të dhënë ndihmën e shpejtë për të dëmtuarit në punë;

Sigurimi i cilësisë së punimeve (kontrolli dhe mirëmbajtja)

- Të shpjegojë rëndësinë e cilësisë së punimeve të kryera në fushën e përpunimit të drurit;
- Të përshkruajë mënyrat e ndryshme të kontrollit të fushën e përpunimit të druri sipas standardit, skicave, modeleve etj.;
- Të përshkruajë mjetet dhe aparatet matëse e kontrolluese të cilësisë së punimeve, në të gjithë sektorët e punimit të drurit;
- Të përshkruajë aspekte të mbikëqyrjes së punëve në proceseve të përpunimit të drurit
- Të shpjegojë mënyrën e monitorimit të punës gjatë proceseve të përpunimit të drurit;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Sipërmarrja dhe menaxhim biznesi

- Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt ide sipërmarrëse (për të zhvilluar dhe zbatuar një buxhet të caktuar);
- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti;
- Të analizojë të dhëna për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të identifikojë dhe të zgjidhë problem në mënyrë krijuese;
- Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive;
- Të vlerësojë risqet sipas proceseve respektive gjatë punimeve, në fushën e përpunimit të drurit;
- Të demonstrojë aftësi për të planifikuar, bërë, kontrolluar dhe vepruar me qëllim për t'u vetë-përmirësuar;
- Të demonstrojë aftësi drejtuese në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të aplikuar parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të motivuar dhe inkurajuar të tjerët në arritjen e synimeve të

tyre;

- Të aplikojë aftësitë për planifikim dhe menaxhim projekti në situata të ndryshme;
- Të sigurojë burime e duhura dhe të marrë përgjegjësinë për t'u kujdesuar për to;
- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës;
- Të hartojë një plan efektiv biznesi në fushën e prodhimeve të objekteve prej druri dhe gjysmë të gatshëm prej druri për krijimin e një biznesi të ri (ose për modifikim, shtesë, rinovimi, të një biznes ekzistues), për njësi të vogla prodhimi, për linja apo reparte prodhimi, duke u bazuar në procedura standarde;
- Të kryejë detyra tekniko-menaxheriale, në mbikëqyrje të inxhinierëve, për realizimin e një plan biznesi, sipas planeve e programeve të hartuara nga menaxheret e nivelit më të lartë ose të një stafi menaxherial;

Normimi i punës, kostot dhe çmimet

- Të marrë pjesë në procesin normimit të punës për produktet prej druri, duke pasur parasysh kohët kryesore të punimit në makineritë dhe pajisjet e ndryshme, si dhe kohët e nevojshme në tërësinë të operacioneve ndihmëse (të përcaktuara në procesin teknologjik), deri në ambalazhimin e magazinimin e tyre;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta të kostos së prodhimit të një objekti prej druri, pllakë me bazë druri, proces restaurimi, arredimi etj. të caktuar, duke marrë parasysh të gjithë elementet e saj, (kostot direkte dhe indirekte);
- Të kryejë llogaritje të thjeshta të çmimit të objektit, restaurimit, arredimit duke marrë parasysh koston e prodhimit dhe gjithë elementet e tjerë që ndikojnë në çmimin e produktit si; fitimin e menduar, sasinë e kërkuar, kërkesën e tregut, çmimin/ofertën e tregut për produkte të ngjashme, cilësitë ose karakteristikat e veçanta të produktit, garancinë, kushtet për mirëmbajtjen dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit etj.);
- Të hartojë preventiva dhe situacione (pjesore dhe përfundimtare) për punime të ndryshme në fushën e përpunimit të drurit në mënyrë të thjeshtë ose duke përdorur teknologjinë e informimit dhe komunikimit me programet llogaritëse përkatëse;
- Në varësi të madhësisë së njësive të përpunimit të drurit, të menaxhojë burimet financiare, (duke u përqendruar në menaxhimin e burimeve të arkës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit që lidhet me blerjet dhe të gjitha shpenzimet e tjera të nevojshme, sipas metodologjisë së përcaktuar për këtë qëllim.

Organizimi i punës

- Të zbërthejë plan-organizimin e punimeve në repart ose fabrikë të përpunimit të drurit;
- Të organizojë llojet e punimit në përpunimin e drurit deri në magazinimin dhe shpërndarjen e tyre;
- Të hartojë urdhra të thjeshtë pune të punimeve në fushën e përpunimit të drurit;
- Të përcaktojë volumet e punës, ndarjen e detyrave sipas (grup) personave përgjegjës, duke respektuar grafikun e punimeve në repartin e punës për fushën e përpunimit të drurit;
- Të zbatojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale përkatëse;
- Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore duke kuptuar sjelljet e individit/grupit dhe duke aplikuar me efikasitet teknikat e motivimit, si uljen apo ngritjen në përgjegjësi,

motivimin material e moral etj.;

- Të llogarisë vëllimin e punimeve në fushën e përpunimit të drurit, të kryera sipas proceseve përkatëse të punës në bashkëpunim me inxhinierin e zbatimit të punimeve;
- Të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm teknik sipas legjislacionit në fuqi;
- Të bashkëpunojë për zbatimin e punimeve të instalimeve të makinave, linjave dhe të transportit të brendshëm etj.;
- Të bashkëpunojë për evidentimin dhe kualifikimin e punëtorëve në repart ose fabrikë;
- Të mbikëqyrë mirëmbajtjen e instrumenteve, veglave, pajisjeve dhe materialeve të punës në mjediset përkatëse;

Proceset e punimet dhe ndjekja e tyre

- Të përgatisë makinat e avancuara nga ana e sigurisë;
- Të programojë makinat e avancuara sipas punimit që do kryhet;
- Të lëshojë makinën e kopjuterizuar për punë;
- Të përcaktojë shtesat e nevojshme për punime;
- Të punojë në makina të kompjuterizuara të përpunimit të drurit;
- Të ndjekë procese pune për pllaka me bazë druri në makinat e avancuara;
- Të ndjekë realizimin e objekteve speciale prej druri, si voza, parket, punime artizanale etj.;
- Të përgatitë elementë specialë (kallëpe, kapriata, binarë etj.) për ndërtim;
- Të ndjekë zbatimin e regjimeve në procese të ndryshme të prodhimit, gjatë trajtimit hidrotermik, termik të drurit, presimit, tharjes, defibrimit etj.;
- Të ndjekë realizimin e recetave të përgatitjes së kimikateve që përdoren, si lëndët ngjitëse, hidrofuge, lustruese, ngjyruese, imprenjuese etj.;
- Të ndjekë ecurinë e proceseve teknologjike të objekteve prej druri dhe pllakave në bashkëpunim me inxhinierin;
- Të përcaktojë vetitë e ndryshme fizike, mekanike etj. të drurit dhe pllakave me bazë druri si pllakë zdrukthi, panel, rimeso, kompensatë etj.;
- Të përcaktojë cilësinë e kompensatës, rimesos, pllakës panel, zdrukthit, fibrës si M.D.F. pllake me dendësi mesatare, pllake melamine etj.;
- Të kryejë në restaurime speciale të mobileve;
- Të punojë në procese arredimi të banesave, institucioneve, ambiente të ndryshme bashkëkohore. etj.;
- Të ndjekë vendosjen dhe kombinimin e aksesorëve të ndryshëm në prodhimin e objekteve prej druri;
- Të përdorë të gjitha mjetet e pajisjet matëse dhe kontrolluese të njësisë së prodhimit/shërbimit;

Menaxhimi i materialeve

- Të hartojë plan-kërkesat për materialet kryesore dhe ndihmëse, si dhe për instrumentet prerës dhe pajisjet përkatëse, duke u nisur nga kërkesat periodike të prodhimit/shërbimit;
- Të respektojë standardet dhe certifikatat për furnizimet (blerjet) e materialeve dhe lëndëve të para e ndihmëse;
- Të krahasojë dhe të vendosë për çmimet e blerjes së materialeve kryesore dhe ndihmëse;

- Të hartojë planin e rezervës së nevojshme të materialeve (stokut), për të garantuar vazhdimësinë dhe vijueshmërinë e punimeve në fushën e përpunimit të drurit;

Standardet teknike në proceset e përpunimit të drurit

- Të zbërthejë vizatime të objekteve në nyje, detale, vendosjen e simboleve, tolerancave, pastërtinë sipërfaqësore etj.;
- Të zbatojë standardet teknike (ISO) në fushën e përpunimit të drurit, menaxhimit dhe mbrojtjes në punë;
- Të lexojë manualat teknike të përdorimit të makinave dhe pajisjeve të ndryshme;
- Të përdorë programe kompjuterike (AutoCAD, ...) për vizatimin e detaleve të thjeshta të drurit etj.;
- Të hartojë kartat teknologjike të detaleve të ndryshme duke përcaktuar dhe kontrollin teknik operacional dhe përfundimtar;

Mirëmbajta

- Të përcaktojë defektet e thjeshta dhe parregullsitë në kryerjen e punimeve repartin e drurit që ai menaxhon, duke gjykuar për shkaqet dhe evitimin e tyre;
- Të realizojë mirëmbajtje, shërbime dhe riparime të thjeshta;
- Të hartojë planet e remontit periodik dhe vjetor për makineritë, pajisjet, impiantet duke parashikuar koston për kryerjen e remonteve;

Informimi dhe komunikimi

- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit, për të bërë të mundur sigurimin e informacionit nga të gjitha burimet e mundshme, si interneti, shtypi, revistat, librat, reklamat, botimet e karakterit periodik teknik etj.,
- Të përdorë programe kompjuterike si: EXEL për preventiva dhe situacione dhe AutoCAD për vizatimin teknik të detaleve, të nyjeve, duke përfshirë simbolet, tolerancat, vendosjet, pastërtinë sipërfaqësore, kushtet teknike, Sketchup për ndërtim objekti në vizatim tre dimensional dhe arredim etj.;
- Të komunikojë në mënyrë etike dhe profesionale me kolegët, eprorët dhe klientët;

Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë

- Të zbatojë legjisllacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, duke përfshirë, përveç aspekteve teknike të sigurisë, plotësimin e dokumentacionit të detyrueshëm për instruktimin e punonjësve;
- Të përdorë pajisjet mbrojtëse individuale dhe kolektive në punë;
- Të afishojë, për çdo post pune, rregullat e sigurimit teknik në punë;
- Të zbatojë legjisllacionin shqiptar parandalimit, mbrojtjes, neutralizimit dhe shpëtimit ndaj zjarri, si dhe evakuimin e punonjësve;
- Të kryejë saktë veprimet e nevojshme për të dhënë ndihmën e shpejtë për të dëmtuarit në punë;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Sigurimi i cilësisë së punimeve (kontrolli dhe mirëmbajtja)

- Të kontrollojë cilësinë e punimeve të kryera në fushën e përpunimit të drurit.
- Të kontrollojë përputhshmërinë e punimeve në fushën e përpunimit të druri me standardet, projektet, skicat, modelet etj.;
- Të përdorë mjetet matëse kontrolluese, aparatet etj. të cilësisë së punimeve, në të gjithë sektorët e punimit të drurit.
- Të monitorojë punën gjatë proceseve të përpunimit të drurit;

Legjislacioni i punës dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të punës, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit.
- Të asistojë në hartimin e një kontrate pune individuale, duke përfshirë, përveç kushteve të përgjithshme edhe ato specifike për llojin e punës që do të kryejë punonjësi.
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë, përveç aspekteve teknike, plotësimin e dokumentacionit të detyrueshëm për raportimet periodike;
- Të kërkojë të zbatohen standardet, urdhrat e sugjerimet e organeve shtetërore për menaxhimin e mbetjeve në njësinë e vet të punës;
- Të kërkojë dhe të përdorë pajisjet e nevojshme për të evituar ndikimin e kimikateve si lëndëve ngjyuese, ngjitime, lustruese, pluhurit të drurit, ashklave etj.
- Të përdorë pajisjet e nevojshme për neutralizimin e gazrave të dëmshëm, të pajisjeve të pastrimit të ujerave të ndotur dhe të mbetjeve të ngurta që janë të dëmshme për mjedisin;

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional dhe ti shpërndajë ato, në dobi të kolegeve e punonjësve në njësisë e tij prodhuese.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente. Të ndër marrë apo hedhë vazhdimisht ide te reja, duke hartuar projekte të reja, struktura të reja organizative, të cilat sjellin përmirësimin e strukturave ekzistuese.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij, te jete i matur dhe i sjellshëm me eporet, vartësit, partneret, etj.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.

- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë aftësitë e tij, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
- Të jetë i hapur dhe të veprojë si një ndërlidhës midis njësisë së tij prodhuese dhe njësive të tjera brenda ndërmarrjes apo ndërmjet ndërmarrjes dhe të tretëve jashtë saj, si furnitorët, klientët, partneret, etj., duke ndihmuar në realizimin e qëllimeve të njësisë prodhuese.
- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar më individë apo grupe;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës proaktiv në grup;
- Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
- Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
- Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
- Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
- Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave..